

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the Permanent Secretary

DATË/A:	16.01.2013
REFERENC-Ë:	12/3010/2- ZSP- 08/13
PËR/ZATTO:	„Mirusha Company“ Sh.p.k. Klinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
NGA/OD/FROM:	Fatmir Morina, Shef i zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës së me nr.prot. 12/3010/2 dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për eksploatin, e gurit gëlqeror në lokalitetin Dresnikë Klinë.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 29.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe nenit 90. të LPA (Nr.02/L-28), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Kompanisë „Mirusha Company“ Sh.p.k. Klinë, për Pëlqim Mjedisor për eksploatimin, e gurit gëlqeror në lokalitetin Dresnikë Klinë .

Mënyra e operimit është e përshkruar në vijim (Arsyetim) dhe është e obligueshme për palën.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, Raportin e VNM-së, dokumentacionin e dorëzuar dhe informatat shtesë, të „Mirusha Company“ Sh.p.k. Klinë, për Pëlqim Mjedisor për eksploatimin, e gurit gëlqeror, në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 857/2, sipërfaqe prej 4.00.00 ha, flet posedimi nr. 174, Zona kadastrale Dërsnik, Klinë, me vizitën e bërë në terren, pas mbajtjes së debatit publik me datë 10.12.2012 dhe pas shqyrtimit të informatave, shtesë vlerëson si vijon:



Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave “ Rilindja” kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net

Në afërsi të lokacionit ku planifikohet të bëhet eksploatimi i gurit gëlqeror ishte duke u eksploatuar guri gëlqeror nga aplikuesi i lartë cekur. Në afërsi të lokacionit ku planifikohet të bëhet eksploatimi i gurit gëlqeror, nuk gjenden objekte të banimit. Karakteristikat mjedisore të kësaj zone nuk do të pësojnë ndryshime të theksuara nga aktiviteti i paraparë, nëse merren masat e shkruara në raportin e VNM-së dhe plotësohen kushtet që do të epen në vijim.

Duke i pasur parasysh faktorët e sipër përmendur, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i jep pëlqim mjedisor për eksploatimin e gurit gëlqeror nën këto kushte:

- Gjatë eksploatimit të respektohen kufijtë dhe rregullat që janë të përkrahura në projektin kryesor të xehtaris për eksploatimin e gurit gëlqeror.
- Gjatë punës duhet të ndërmerren të gjitha masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, evitimin nga derdhja e vajrave të makinave, evitimin nga derdhja e karburanteve e posaçërisht gjatë furnizimit të makinave.
- Të bëhet sistemi për grumbullimin e ujërave nga sipërfaqet operacionale, dhe të hapet kanali për rreth minierës me qëllim të mbledhjes së ujërave atmosferike të ndotura, të grumbullohen dhe orientohen në pajimet për trajtimin e ujërave, në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor.
- Të rregullohen pajimet për trajtimin e ujërave atmosferike nga sipërfaqet operacionale (pusët sedimentuese), në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor.
- Të vendosen pajimet adekuate për mbeturinat të ngurta dhe lëngta.
- Në kohra të nxehta të bëhet stërpikja e sipërfaqeve manipuluese kohë pas kohe, me ujë, me qëllim të zvogëlimit të pluhurit gjatë transportit, gjithashtu kamionët gjatë transportit të materialit duhet të mbulojnë me mbulesë adekuate.
- Të bëhet thurja e ngastrës me tel gjëmbor, në afat kohor prej dy muajsh nga dita e marrjes së këtij pëlqimi mjedisor.
- Pas eksploatimit të kryhet rikultivimi i zonës së shfrytëzuar duke iu përshtatur projektit për rikultivimin e karrierës.
- Aplikanti përpos kushteve të lartshënuara duhet të u përmbahet edhe kushteve të paraqitura në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura në afat të caktuar, pëlqimi do të anulohet (merret).



Pëlqimi Mjedisor është kusht për marrjen e Licencës për Shfrytëzimin e Resurseve Natyrore, Mineraleve, etj.

Ky Pëlqim Mjedisor vlen për dy vite konform nenit 25 te Ligjit për VNM Nr. 03/L-214.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur, ka të drejtë në inicimin e procedurës së kontestit administrativ, në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor


Nr. 12/3010/2- ZSP- 08/13 datë:16.01.2013

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Arkivit të MMPH-së

Sekretar i Përgjithshëm


Arben Çitaku



Faqe 4 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net